



Prishtinë, 01 korrik 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2226_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike LIGJI Nr.05/L - 085;
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dispozitat e nenit 75 të Ligjit për Procedurën Administrative;
- Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.9/15, të dt. 17.01.2028;
- Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës ne Prishtine Ac.nr.700/2018 i datës 08.05.2020;
- Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës me nr. KE.nr.731/22;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2555_05_24** i datës 30.05.2024 dhe
- Ankesa e konsumatorit e datës 19.06.2024.

në seancën e mbajtur më datë 01 korrik 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZHET si e pabazuar** ankesa e konsumatorit **DPT Trimi – A.O nga Komuna e Vushtrrisë** e parashtruar ndaj vendimit të DMK-së;
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2555_05_24 i datës 30.05.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 30.05.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2555_05_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së kishte kërkuar shlyerjen e borxhit/faturës së rikthimit të humbjeve me nr. DMI14HP06639 të dt. 16.09.2014 në vlerë financiare prej **796.93€**, të ngarkuar nga KEDS për shkak të shfrytëzimi të paautorizuar të energjisë elektrike.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori **DPT Trimi – A.O (N.O)** brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori i është adresuar gjykatave kompetente sipas udhëzimeve juridike të vendimeve administrative dhe gjyqësore;



- Pavarësisht këtyre veprimeve procedurale, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, e ka shpallur veten jokompetente për shqyrtim dhe vendosje dhe në arsyetim konsumatorin e ka udhëzuar që t'i drejtohet ZRrE-së;
- Se KEDS nuk ka parashtruar kallëzim penal dhe nuk ka iniciuar procedurë përmbarimore ndaj konsumatorit dhe se;
- Konsumatori me vendimin e kontestuar ka mbetur pa zgjidhje ligjore;
- Kërkon që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit dhe të obligohet KEDS që t'ia shlyejë borxhin e faturuar në emër të rikthimit të humbjeve në vlerë prej 796.93 €.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 01.07.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 19.06.2024; Vendimin e DMK të datës 30.05.2024; Ankesën e konsumatorit në KEDS të datës 30.09.2014; Përgjigjen e KEDS të datës 22.12.2014, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 13.05.2024; Padinë e dt. 05.01.2025, Aktvendimin C.nr. 9/15; Ankesën e dt. 29.01.2028; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.700/18; Aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së parë KE.nr.731/22; Certifikatën mbi dënimet penale të konsumatorit të dt. 10.06.2024; Faturën e rikthimit të humbjeve të dt. 16.09.2014; procesverbale dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me datë 13.05.2024 ka pranuar ankesën e konsumatorit A.O DPT "T" i cili ka kundërshtuar faturën e rikthimit të humbjeve **DMI14HP06639 të datës 16.09.2014 në vlerë financiare prej 796.93€** të ngarkuar nga KESCO për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, me kërkesën që ky borxh të shlyhet.

Me datë 16.09.2014, KEDS e ka ngarkuar konsumatorit DPT Trimi – Abaz Osmani, me Faturën e Rikthimit të Humbjeve, duke u bazuar në procesin e dt. 11.09.2024, me nr. 11339657, në vlerë prej **796.93€**.

Brenda afatit ligjor, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEDS, me kërkesën për shlyerjen e kësaj fature. Dhe me datë 22.12.2024, nga KEDS – Distrikti i Mitrovicës, i janë përgjigjur konsumatorit në ankesën e tij, duke e refuzuar të njëjtën dhe se konsumatori është udhëzuar që të inicioj kontest në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor prej 14 ditësh.

Sipas udhëzimit të KEDS, brenda afatit ligjor konsumatori ka parashtruar Padi vërtetimi, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, me kërkesën që vendimi për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të humbjeve të refuzohet si e pabazuar, i pa argumentuar e në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.



Me datë 17.01.2028, Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, ka nxjerr Aktvendim me shenjën C.nr.9/15, me të cilin kjo gjykatë është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore, për gjykim dhe vendosje në këtë çështje juridike, ashtu që, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda me shkresat e saj të dërgohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

Brenda afatit ligjor, konsumatorit ka parashtruar ankesë ndaj këtij Aktvendimi, pranë Gjykatës së Apelit, me kërkesën që, lënda të kthehet në rigjykim, dhe të vërtetohet drejt gjendja faktike. Dhe me datë 08.05.2020 Gjykata e Apelit të Kosovës, nxjerrë Aktvendim me shenjën Ac.nr.700/18, përmes të cilit, e aprovon si të themeltë ankesën e konsumatorit, dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore për rigjykim dhe rivendosje.

Konsumatori po ashtu ka parashtruar Padi pranë Gjykatës Komerciale, dhe me datë 25.04.2024, nxjerr Aktvendim me shenjën KE.nr.731/22, përmes të cilit shpallët jokompetente në pikëpamje lëndore, shpallen të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e kësaj gjykate në këtë çështje kontestuese dhe hedhet si e palejuar padia e paditësit. Padi që gjykata e kishte shqyrtuar paraprakisht këtë padi, ka konstatuar se, kompetente për të vendosur për këtë kontest është Zyra e Rregullatorit për Energji, pasi që objekti i kontestit ka të bëjë me natyrën administrative.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, pasi që kishte analizuar vendimet gjyqësore, ankesat dhe padinë e parashtruar nga konsumatori, si dhe faturën e rikthimit të humbjeve dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se, ankesa e konsumatorit ka të bëjë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike dhe se, duke u bazuar në dispozitat e nenit 4 par. 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si vijon: *“Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin e XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale Kundër Pasurisë, ku përfshihet edhe vjedhja e energjisë elektrike janë nën juridiksionin e gjykatë kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen me këtë rregull”,* e shpallë vetën jokompetente për shqyrtimin dhe trajtimin e kësaj çështje, sepse, ZRrE nuk ka mandat që të shqyrtoj ankesat dhe çështjet tjera si Fatura e Rikthimit të Humbjeve, pasi që kanë elemente të veprës penale – si vjedhja e energjisë elektrike, dhe rrjedhimisht, sipas legjislacionit në fuqi, këto çështje shqyrtohen dhe zgjidhen nga gjykatat kompetente.

ZRrE ju njofton që, Fatura e Rikthimit të Humbjeve, është faturim për periudhën gjashtë (6) mujore, sipas nenit 13 – Llogaritja dhe faturimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, si vijon: *“Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike sipas 9.2 dhe 9.3 të kësaj procedure nuk mund të përcaktohet, atëherë për konsumatorët familjar do të merret që 9 shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë ka filluar gjashtë (6) muaj, ndërkaq për konsumatorët tjerë dymbëdhjetë (12) muaj para datës kur konsumatori është zbuluar, ose nga data e inspektimit të fundit kur instalimi ka qenë në rregull. 13.2 Nga sasia e energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar e përcaktuar nga Departamenti i Faturimit duhet të zbritet sasia e energjisë elektrike që është faturuar/regjistruar në njehsor gjatë asaj periudhe”.*

Bordi i ka shqyrtuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit, dhe thekson se, si të tilla janë të pa bazuara, sepse siç është cekur në vendimin e kontestuar të DMK-së, Zyra e Rregullatorit për Energji,



nuk ka mandat që të shqyrtoj ankesat e konsumatorëve që ndërlidhen me elementet e veprës penale. Gjegjesisht, fatura e rikthimit të humbjeve, është faturë e cila i ngarkohet konsumatorit për shkak të dëmit që ia ka shkaktuar kompanisë, me rastin e keqpërdorimit të energjisë elektrike ose veprës penale të Vjedhjes së Shërbimeve, sipas nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Bordi i pati parasysh edhe pretendimet e tjera ankimore të konsumatorit, që i licencuari KEDS nuk ka parashtruar kallëzim penal ndaj konsumatorit, dhe nuk ka iniciuar ndonjë procedurë tjetër, siç është procedura përmbartimore për arkëtimin e këtyre mjeteve, dhe thekson se, KEDS ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, por që, përsëri, trajtimi i kësaj ankese nga Bordi, mbetet jashtë mandatit të tij, sepse, organe kompetente për shqyrtimin e veprave penale janë organet e drejtësisë në nivel vendi.

Andaj, nga sa u tha më sipër, Zyra e Rregullatorit për Energji e ka shpallur veten jo kompetente për shqyrtim dhe vendimmarrje lidhur ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit: **DPT Trimi – A.O (N.O)** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.